

AKT – THEMELIMI
I SHOQERISE TREGTARE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
"VIATECH" SHPK

Bazuar ne vullnetin e ortakeve dhe mbeshtetur ne Ligjin 9901 date 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", ndryshuar me Ligjin nr. 10 475, date 27.10.2011 vendoset si me poshte:

Kreu I

Themelimi, Emri, Objekti, Kohezgjatja dhe Selia e Shoqerise.

Neni 1:

Themelimi, Themeluesit, Emri.

Sot me date 21/3/2024 themelohet shoqeria me pergjegjesi te kufizuar me emrin:

"VIATECH" SHPK

Themeluesit e shoqerise **"VIATECH" SHPK** jane;

- **Z. AMBI GJOKA**, shtetas Shqiptar, i biri i Ilir, i datl. 07/01/1997, lindur ne Tirane, mbajtes i kartes se Identitetit me Nr.J701070550, madhor me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar;
- **Z. SEAD MUSA**, shtetas Shqiptar, i biri i Sabah, i datl. 09/02/1987, lindur ne Shkoder, mbajtes i kartes se Identitetit me Nr. I70209097B, madhor me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar;

Te cilet redaktojne kete Akt-Themelimi, ne perputhje me ligjet e Republikes se Shqiperise nr. 9901 date 14.04.2008, "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", i ndryshuar dhe ligjit 9723 date 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit", te ndryshuar.

Neni 2:

Objekti i Shoqerise.

Ofrim i zgjidhjeve ne fushen e teknologjise se informacionit, ndertim dhe implementim te sistemeve IT. Ofrimin e sherbimeve te ndryshme IT, mbeshtetje IT, zhvillime software sherbime dhe konsulence te ruajtjes dhe sigurise se te dhenave. Sherbime riparimi dhe mirembajtje ne terren per paisjeve te teknologjise se informacionit, mirembajtje dhe marketing APP (aplikacioneve). Dizenjim dhe ndertim dhe instalim i sistemeve te komunikimit ne rrjete. Konsulence ne fushen e teknologjise se informacionit, konsulence financiare dhe administrim biznesi. Tregtim import / eksport te sistemeve elektronike dhe paisjeve ne fushen e teknologjise se informacionit. Per me teper shoqeria mund te veproje si agjent/ndermjetes per kryerjen e aktiviteteve te mesiperme dhe bazuar ne diskrecionin e saj te vetem mund te kontraktoje pale te treta per kryerjen e nje pjese apo te te gjitha sherbimeve te mesiperme. Gjithashtu, Shoqeria mund te kryeje çdo aktivitet tjeter te nevojshem apo te dobishem per realizimin e

Leud m... P. u.

Ambi Gjoka

qellimeve te saj perfshire edhe aktivitetin e ofrimit te sherbimeve, tregtimin, importimin dhe eksportimin e mallrave. Per te arritur objektin e saj, Shoqeria mund te realizoje drejtperdrejte apo ne menyre te terthorte çdo lloj pjesemarrje ne shoqeri te tjera shqiptare apo te huaja, si edhe te hyje ne marredhenie kontraktore, bashkepunimi ose ortakerie me persona te trete, private ose publike, vendas ose te huaj.

Neni 3:

Kohezgjatja e shoqerise.

Kohezgjatja e shoqerise do te jete per nje periudhe te pacaktuar.

Neni 4:

Selia e shoqerise

Rruga e Kavajes, objekti GARDEN BUILDING, apartamenti, nr.1A/13/1, ZK 8210 Tirane

Kreu II

Kapitali i shoqerise.

Neni 5:

Vlera dhe pagesa e kapitalit te paguar

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 1 000 000 (nje milion) leke. Pjesemarrja e themeluesit ne kapitalin e shoqerise eshte si vijon :

Lloji i kontributit eshte ne para ne vleren 1 000 000 (nje milion) leke, i ndare ne 2 kuota me vlere;

- **Z. Sead MUSA**, eshte zoterues i 1 (nje Kuote) me vlere 200 000 Lek (Dyqindmije lek), qe korrespondon ne 20% te Kapitalit te Shoqerise.
- **Z. Ambi Gjoka**, eshte zoterues i 1 (nje Kuote) me vlere 800 000 Lek (teteqindmije lek), qe korrespondon ne 80 % te Kapitalit te Shoqerise.

Kreu III

Administratori i shoqerise.

Neni 6:

Emerimi dhe kohezgjatja e Administratorit.

Asambleja e pergjithshme zgjedh nje ose me shume persona fizike si administratore te shoqerise per nje periudhe pese vjecare (5 vjet), ne pajtim me parashikimet e Ligjit 9901 date 14.04.2008, i ndryshuar. Emertimet do te jene individuale dhe sipas nje vendimi te marre me shumice te zakonshme nga Asambleja e Pergjithshme. Administratori i shoqerise do te jete **Z. AMBI GJOKA**, shtetas Shqiptar, i biri i Ili, i datl. 07/01/1997, lindur ne Tirane, mbajtes i kartes se Identitetit me Nr.J701070550, madhor me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar;

Sead MUSA

Ambi Gjoka

Kreu IV

Dispozitat Perfundimtare.

Neni 7:

Marredheniet e punesimit ne shoqeri do te rregullohen nepermjet kontrates se punesimit qe lidhet midis paleve ne mbeshtetje te Kodit te Punes si dhe akteve nenligjore te dala ne zbatim te tij.

Ortaku /Ortaket e shoqerise nuk kufizohen ne rritjen e kapitalit te Shoqerise.

Mosmarreveshjet qe mund te lindin gjate ushtrimit te veprimtarise private, midis ortakeve, punonjesve dhe personave te trete, kur ato nuk mund te zgjidhen me mirekuptim, mbetet ne kompetence te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane.

Shoqeria do te kete vulen e saj ku jane percaktuar dhe inicialet e emertimit tregtar.

Modalitet per ndryshimin dhe kompetencat e administratorit, kompetencat dhe marrja e vendimeve te Asamblese se Pergjithshme, zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit themeltar, etj, do te rregullohen nga Statuti i Shoqerise dhe Ligji 9901 14.04.2008 "2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", i ndryshuar si dhe Ligji 9723, date 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit", i ndryshuar.

Ky akt themelimi eshte perpiluar ne kater kopje me vlere te njejete me origjinalin.

Tirane, me date 21/03/2024

THEMELUESIT

Z. AMBI GJOKA

Z. SEAD MUSA

AMBI GJOKA

Sead Musa L.M.

Amber Gjoka